



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Strugë, 1 korrik 2013

**Fillimi zyrtar i Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar  
Greqia – ish Republika Jugosllave e Maqedonisë  
[Thirrja e 3<sup>të</sup> për Propozim Projekte]**

Fjalim

Ambasadori Aivo Orav

Shef i Delegacionit të BE-së

**I nderuari Ministër Hani,**  
**E nderuara zj. Kërliu**  
**I nderuari z. Emmanouil,**  
**E nderuara kolege, zj. Sharlamanov,**  
**Zonja dhe zotërinj,**

- Kam kënaqësinë që jam këtu sot për të shpallur të hapur edhe një – Thirrjen e tretë për Propozim Projekte në suaza të Programit Ndërkufitar me Greqinë.
- Ekzistimi i kufijve imponon edhe ekzistimin e pengesave administrative, ligjore dhe fizike. Ato mund të shkaktohen nga dallimet në institucionet politike, sistemet dhe procedurat administrative, strukturat ligjore ose standardet teknike dhe mjedisore.
- Bashkëpunimi Ndërkufitar ka për qëllim të tejkalojë këto pengesa me anë të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Karakteristikat e çdo vendi janë marrë parasysh por edhe natyra dhe kultura e pandashme. Autoritetet dhe strukturat relevante, në nivele të ndryshme të qeverisë dhe pushtetit, mësohen të punojnë së bashku. Përmes menaxhimit të përbashkët, besimi dhe kuptimi reciprok janë forcuar dhe procesi i bashkëpunimit është përmirësuar. Prandaj bashkëpunimi ndërkufitar është faktor kryesor i integritit evropian dhe kohezionit ekonomik dhe social.

- Bashkëpunimi ndërkufitar ka të bëjë me dhënien e mundësisë për njerëzit në të dyja anët e kufirit të bashkëpunojnë dhe përmirësojnë kushtet ekonomike, sociale dhe mjedisore të rajonit të tyre në nivel vendor. Atyre u ofrohet mundësia të përmirësojnë kushtet jetësore të popullatës. Lidhjet ekonomike dhe personale që po ndërtohen janë në fakt gurthemet e prosperitetit të rajonit të tyre në të ardhmen. Këto janë vetëm prova të thjeshta të 'efektit të shumëzimit' të cilin e prodhon bashkëpunimi ndërkufitar.
- Sot po shpallim të hapur Thirrjen e tretë për Propozim Projekte për bashkëpunimin ndërkufitar mes dy vendeve fqinje. Në roundin e parë u kontraktuan 18 projekte, me vlerë gjithësej 5 milionë euro. 20 projekte të tjera u zgjodhën në roundin e dytë me vlerë prej 17 milionë euro. Në suaza të këtij roundi të tretë, BE-ja ka rezervuar gjithësej 7,5 milionë euro.
- Projektet e implementuara deri më tani kategorizohen nga bashkëpunimi ekonomik deri në projektet e zhvillimit turistik dhe të këmbimit kulturor. Si rezultat i kësaj, komunat, Odat Ekonomike, institucionet shëndetësore, organizatat mjedisore nga të dyja anët përfitojnë nga partneritetet e frytshme. Mirëpo ajo që është arritur deri më tani, nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin e hapur dhe të fuqishëm, të zhvilluar përtej kufirit nga autoritetet e të dyja vendeve.

- Numri i madh i njerëzve të pranishëm sot është vetëm një vërtetim i synimit të të dyja vendeve për të vazhduar bashkëpunimin e tyre – jo vetëm mes ministrave të përfshira por gjithashtu edhe mes institucioneve të shumta, komunave, ndërmarrjeve dhe OJQ-ve, të cilët janë partnerët potencialë të projekteve në kuadër të kësaj Thirrjeje.

Ju dëshiroj shumë sukses!